

## Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “FEDAS” SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, në mënyrë të lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, unë ortaku dhe z.Xhevdet Cela me nr. kartë identiteti G4113054J, lindur dhe banues në Kavajë, krijoj shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**FEDAS**” SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi  
Neni 1

Sot me datë 22.04.2022, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**FEDAS**” SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqërisë.  
Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, Kavajë, Lagja nr 03, Rruga Qazim Kariqi, objekt 2 katesh, kati 1, nr 32  
Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese dhe ortakeve të saj.

Objektivi i Veprimtarisë  
Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:  
Import dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të kafesë së bluar. Tregti me shumicë dhe pakicë, të të gjitha llojeve të embelsirave dhe të mini produkteve të kripura. Ushqim katering. Pike shitje.

Kohezgjatja e Shoqërisë  
Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë  
Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.000.000 (dy milion) Lekë.

1. Ortaku themelues z.Xhevdet Cela: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2.000.000 (dy milion) leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

## Drejtimi i Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Z. Sindi Cela, e cila do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ajo eshte perfaqesuesja e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

### Neni 8

Ortaket kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

### Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

### Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

### Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "**FEDAS**" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortakët.

Ortaku themelues:

Xhevdet Cela

